

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin Mustaf Tahiri dhe procesmbajtësen Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurës M.A. nga Ferizaj rr.”.....” pn, me vendbanim në fsh..... komuna Vitisë, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP nr. 1309-1/13 të dt.15.11.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë publik, në praninë e prokurorit të shtetit, Visar Musa, të dëmtuarit B.H., të pandehurës dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.H.N., më dt. 04.05.2016 të njëjtën ditë morri dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

E pandehura **M.A.** nga Ferizaj rr.”.....” pn, me vendbanim në fsh..... komuna Vitisë, data e lindjes në ....., nga i ati A. dhe e ëma B. e gjinisë H., ka të kryer shkollën fillore, amvise, e martuar, nënë e një fëmije, e gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal ....., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,

### **LIROHET NGA AKUZA**

Sepse më datën 28.09.2012 në orë të pacaktuar, në rr.” n’ Ferizaj, në shtëpinë e të dëmtuarit B.H., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, në atë mënyrë që ka shfrytëzuar momentin dhe nga dhoma e fjetjes ka marrë një kuti në të cilën kanë qenë të vendosura një sasi e arit dhe atë një zingjir ari i dorës në vlerë 500€, dy rrathë dorë në vlerë 200€, një zingjirë qafe në vlerë prej 400€ si dhe 3 unaza në vlerë prej 500€, e në vlerë të përgjithshme prej 1.600€ dhe largohet nga aty pa u vërejtur nga askush .

### **Me këtë kishte për të kryer veprë penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së**

I dëmtuari B.H. nga Ferizaj, rr.”Dukagjini” nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### **A r s y e t i m i**

PPK në Ferizaj me akakuzën PP.nr.1309-1/13 të dt.15.11.2013 ka ngarkuar të pandehurën, M.A. nga Ferizaj për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt.04.05.2016 në të cilën shqyrtim përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit, Visar Musa lexoj aktin akuzues, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare mbeti në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të saj, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuaren të shpall fajtor dhe të i shqiptohet një sanksion penal i paraparë me ligj.

E akuzuari M.A. në prezencën e mbrojtësit të saj av.H.N. në mbrojtjen e sajë në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shtuar se me bashkëshorten e të dëmtuarit B.H. e ka pasur shoqe dhe te e njëjta ka shkuar here pas here për qejf në shtëpinë e të dëmtuarit pasi që atë kohë kam qenë e pa martuar, por kur nuk kam qenë në atë shtëpi asnjëherë pa prezencën e të dëmtuarve si dhe asnjëherë nuk ka qëndruar vetëm apo me fëmijët e të dëmtuarit në shtëpinë, si dhe asnjëherë nuk ka hyrë në dhomë të gjumit të të dëmtuarit përveq dhomës së ndejës dhe korridorit. Në kohën kur me ka ftuar i dëmtuari B.H. kur kam shkuar në shtëpinë e tij i njëjti me ka goditur, dhe un nuk e dija se çka ka ndodhur por vetëm me tha se ti ma ke vjedhur arin dhe duhet të ma kthesh, ndërsa në stacionin policor asnjëherë nuk i jan marr shenjat e gishtërinjve.

Gjykata pas vlersimit të këtyere provave një nga një dhe në lidhëshmerinë e tyre reciproke dhe gjeti se nuk është provuar se e pandehura ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I dëmtuari B.H., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me të pandehurën jetojnë në të njëjtën lagje dhe se familjarisht kan pasur raporte të mira mes vete, duke theksuar se e pandehura ka ardhur shpesh në shtëpinë e tij pasi që e njëjta është shoqëruar me bashkëshorten dhe fëmijët e tij. I njëjti ka deklaruar se i kujtohet data 28.09.2012 kur e ka kuptuar dhe ka marr vesh që i është vjedhur ari në shtëpinë e tij, mirëpo se kur ka ndodhur kjo se kur i ka humbur ari në shtëpinë e tij nuk e din, por deri sa me dt.28.09.2012 ka kërkuar nga bashkëshortja e ti që t'ia sjell zingjirin e arit i cili i ishte këputur disa ditë me herët dhe të njëjtin ta dërgon për ta rregulluar tek argjendari, i njëjti ka deklaruar se kur i ka thënë bashkëshortes që të shkon tja sjell këtë zingjir e njëjta fillimisht hezitoi dhe nuk shkoi për ta gjetur duke thënë hajt se më vonë, dhe deri sa gruaja ime shkoi për të ma sjell zingjirin me tha se ari nuk qenka në vend dhe po mungon dhe unë pasi pashë që ari po mungon dhe nuk mund ta gjenim unë për këtë kam dyshuar tek M.A. pasi që dy-tre ditë para se të ndodhte kjo e njëjta ka ardhur në shtëpinë tonë. Pas kësaj unë e kam porositur vajzën time që të shkoj ta thëras M.A., mirpo e njëjta nuk ka ardhur, mipro më vonë ka ardhur dhe e kam pyetur se a ma ke vjedhur arin ti e njëjta me tha jo nuk e kam vjedhur unë, mirpo unë prapë i kam thënë që të ma kthesh arin pasi që unë kam dyshuar në të ose do ti tregoj vëllaut tënd për këtë, e njëjta me ka thënë se ndash thuaj vëllaut tim ndash mos i thuaj, mirpo nëse ti bisedon me vëllain tim për këtë ai mund të më largoj nga shtëpia. I njëjti ka shtuar se M.A. i ka thënë se do të bisedoj me të dashurin e saj dhe do ta kompensoj këtë vetëm mos i trego vëllai sepse sipas të dëmtuarit vëllai i të pandehurës është i “ashpër”. Pas kësaj unë kam biseduar me vëllain e të pandehurës S. dhe i tregova se me ka humbur ari dhe se të vetmin dyshim e kam tek M.A., mirëpo ai nuk priti shumë dhe më tha se ja ku është M.A. bëj çka të duash me të. I njëjti ka shtuar se nuk e pandehura asnjëherë nuk ka qëndruar në shtëpinë e të dëmtuarit pa prezencën e bashkëshortes së tij dhe se asnjëherë nuk e ka parë M.A. duke dalë nga shtëpia e tij deri sa aty nuk ka qenë prezent askush.

Gjykata me kujdes e vlerësoi dëshminë e të dëmtuarit B.H. dhe vlerësoi se kjo dëshmi nuk është e mbështetur edhe në prova tjera materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor.

Në dëshminë e tij edhe vetë i dëmtuari ka deklaruar se “ka dyshuar” tek e pandehura M.A.<sup>1</sup>, e po ashtu i dëmtuari gjatë deklarimit të tij ka pohuar faktin se të pandehurën asnjëherë nuk e ka parë të ketë qëndruar aty pa prezencën e bashkëshortes së tij dhe se asnjëherë nuk e ka parë të pandehurën të ketë dalur nga shtëpia e tij deri sa aty nuk kishte qenë prezentë askush<sup>2</sup>. Andaj gjykata vlerëson se një dëshmia e të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor se e pandehura M.A. i ka vjedhur arin në shtëpinë e tij, nuk është e mbështetur në ndonjë provë tjetër materiale që do ta vërtetonin në mënyrë të pa dyshimit se e pandehura ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata po ashtu vlerësoi me kujdes edhe pretendimin e prokurorit publik se në rastin konkret në veprimet e të pandehurës qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, por gjykata pretendimin e akuzës e vlerëson si jo bindës dhe se i njëjti pretendim nuk mbështetet me provat e ofruara nga prokurori i shtetit dhe të administruara në shqyrtimi gjyqësor.

Prandaj sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret me provat e propozuara dhe të zbatuara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se e pandehura ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata në kuptim të nen. 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së të KPPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari B.H. nga Ferizaj, rr.”.....” nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P.nr.1755/13 të dt. 04.05.2016**

Procesmajtësja,  
Drita Ujupi

**Gj y q t a r i,**  
Mustaf Tahiri

**KËSHILLA JURIDIKE** – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

---

<sup>1</sup> Shih proceverbalin e dt.04.05.2016 faqe 5

<sup>2</sup> Shih procesverbalin e dt.04.05.2016 faqe 6

